



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.
DEPARTAMENTI TEKNIK
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Nr. _____ Prot.

Durrës, më ___/___/2024

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës -Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Objekti i prokurimit: “Studim projektim për rikonstruksionin e rrjetit të ujësjellësit në Nj.Adm.Synej, Nj.Adm.Golem, Nj.Adm. Fushë Kuqe, Nj.Adm.Thumanë, Nj.Adm.Maminas, Nj.Adm.Manëz dhe në Nj.Adm.Rrashbull”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 22114311-5 - Projekte, 79415200-8 - Shërbime të konsulencës në projektim

Vlera e fondit limit: 155,534,200.15 (njëqind e pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind pikë pesëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH

Burimi i Financimit: Vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, sipas Shkresës të Agjencisë Kombëtare Ujësjiellës-Kanalizime me Nr. 154 Prot, të datës 08.04.2024, protokolluar me tonën Nr.1626 Prot., datë 11.04.2024, Lënda “Dërgohet detajimi i buxhetit 2024-2026 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj për programin furnizim me ujë dhe kanalizime”, miratuar “*Studim projektim për rikonstruksionin e rrjetit të ujësjellësit në: Nj.Adm.Synej fshatrat: Rrakell, Bukaq; Nj.Adm.Golem fshatrat: Agonas, Kolje, Qerret, Bashkia Kavajë; Nj.Adm.Fushë Kuqe fshatrat: Gore, Patok, Shellinze, Adriatik, Bashkia Kurbin; Nj.Adm.Thumane fshatrat:*

1

Dukagjin i Ri, Sukth Vendas, Bashkia Krujë dhe Nj.Adm.Maminas fshatrat: Karpen, Vlashaj, Metallë, Bodinak, Koxhas, Borak, Bashkia Shijak; Nj.Adm.Manëz fshatrat: Radë, Kameronas, Manëz fshat, Kuçok, Lagja e Re, Shkallë, Armathë, Hamallaj, Borce, Kullë dhe në Nj.Adm.Rrashbull fshati Romanat, Bashkia Durrës”, 37,328,208 lekë me tvsh, Buxheti për 2025: 55,992,312 lekë me tvsh, Buxheti për 2026: 93,320,520 lekë me tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor SHRUKD SH.A, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

Çmimi	pikët 50
Propozimi Teknik	pikët 50

Bazuar në pikën 4 neni 45 të VKM 285 datë 19.05.2021 ku autoriteti mund të mbështetet në ofertën ekonomikisht më të favorshme të bazuar në kosto.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Lista e çmimeve të shërbimeve, sipas Shtojcës 2;
- c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- d. Lista e Informacionit Konfidencial, sipas Shtojcës 4;
- e. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdëklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

f. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdëklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “a” formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, Operatori Ekonomik duhet të plotësojë kërkesat ligjore sipas pikës 1 të Shtojcës 8 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, Operatori Ekonomik duhet të plotësojë kërkesat ligjore sipas pikës 1 të Shtojcës 8 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2021, 2022, 2023) që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, Dega e Tatimit Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009. *Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

*Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:***

i)totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

- b) Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% të vlerës së parashikuar të kontratës objekt prokurimi .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedures eshte "E Hapur Sherbime", percaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa "a" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar ku percaktohet se: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar” si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar; VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik” ku përcaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

- c) Operatori Ekonomik duhet të paraqesi vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar).

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 76, pika 2, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024, pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme në shërbimet e realizuara, sipas nenit 41 të rregullave të prokurimit publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Shërbime të ngjashme shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 30% e fondit limit të objektit të prokurimit, të realizuara gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën, vërtetimet të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën, faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si kontrata/referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin publik dhe atë privat.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensë profesionale për Projektim, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, (sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi) për këto kategori:

- **3 b,** Projektim; 1. Objekte civile-industriale–turistike prej murature e skelet beton arme mbi 5 kate – 2.Objekte me skelet metalik.
- **3 d,** Vleresimi i kapaciteteve mbajtës dhe perforcimi strukturave mbajtës beton-arme, murature dhe metalike.
- **4 f,** Projektim të sistemeve kundra zjarrit.
- **5 b,** Projektim Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.
- **5 c,** Projektim ujësjellës kanalizime urbane – rurale.
- **6 b,** Rruge urbane kryesore dhe rruge interurbane kryesore.
- **7 b,** Projektim ura dhe vepra arti mbi 10 m.

Sqarim: *Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”i ndryshuar me VKM. Nr. 943 date 28.12.2016. Ofertuesit duhet të sjellin Liçencat e rinovuara në zbatim të këtij vendimi.*

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licencat e mesiperme janë vendosur në kuader të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këto procedurë.

3 b, Projektim; 1. Objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet beton arme mbi 5 kate – 2.Objekte me skelet metalik.

Nevojitet për llogaritjen e strukturave B/A si depo, puseta, kalime kanalesh dhe ura etj.

3 d, Vlerësimi i kapaciteteve mbajtës dhe performimi strukturave mbajtëse beton-arme, murature dhe metalike.

Nevojitet për vlerësim të strukturave ekzistuese si depo B/A, puseta kalime kanalesh dhe ura etj.

4 f, Projektim të sistemeve kundër zjarrit.

Nevojitet për llogaritjen e sasise së ujit të hidranteve në vendet kryesore të rrjetit të ujësjes.

5 b, Projektim Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

Projektim i rrjetit të furnizimit me ujë të objekteve, llogaritjet hidraulike etj.

5 c, Projektim ujësjes kanalizime urbane – rurale.

Projektim i rrjetit shpërndarës, rrjetit kryesor të furnizimit me ujë dhe llogaritjet hidraulike etj.

6 b, Rruge urbane kryesore dhe rruge interurbane kryesore.

Projektim i shtresave rrugore të nevojshme për nderhyrjet që do kryhen për vendosjen e tubave në rrugët e zonave ku shtrihet rrjeti ujësjes me qëllim kthimin në gjendjen e mëparshme.

7 b, Projektim ura dhe vepra arti mbi 10 m.

Projektim vepra arti për kalim të tubave në pengesa si perrenj, lumenj, kanale ujësjes dhe vadites etj.

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të jetë licënsuar nga Q.K.L. III.2.A për “Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Auditimin Mjedisor”.

Argumentimi: Ky kriter bazohet në Nenin 3 të ligjit Ligji Nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” “...Ky ligj zbatohet për projektet e propozuara, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendndodhjes së tyre...”.

Nevojitet për paisjen me Leje Mjedisore për tu paisur me Leje Nderimi ose Infrastruktura nga pushteti vendor. Eksperti që harton raportin duhet të jetë i regjistruar në QKL sipas legjislacionit në fuqi ligjit Nr.10 081 , datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM Nr.538 date 26.05.2009 “Për Licencat dhe Lejet Që Trajtohen Nga Apo Njëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe Disa Rregullime të Tjera Nënligjore të Përbashkëta”

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te jete licensuar nga Q.K.L. I.2.A per “Sherbime ekspertize ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin”.

Argumentimi: Ky kriter bazohet ne Nenin 39, te Ligj Nr. 152/2015 “Për Shërbimin E Mbrojtjes Nga Zjarri Dhe Shpëtimin” “...Projekti për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin është pjesë përbërëse e dokumentacionit që kërkohet për lëshimin e lejes së zhvillimit/ndërtimit...”

Nevojitet per paisjen me Leje nga sherbimi MZSH per tu paisur me Leje Ndertimi ose Infrastruktura nga pushteti vendor. Eksperti qe harton raporti duhet te jete i regjistruar ne QKL sipas legjislacionit ne fuqi ligjit Nr.10 081 , datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet Dhe Lejet Në Republikën E Shqipërisë”, VKM Nr.538 date 26.05.2009 “Për Licencat Dhe Lejet Që Trajtohen Nga Apo Nëpërmjet Qendrës Kombëtare Të Licencimit (QKL) Dhe Disa Rregullime Të Tjera Nënligjore Të Përbashkëta” si dhe per projektimin e vendosjes se hidranteve te zjarrit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë si drejtues teknikë stafin si më poshtë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licensë profesionale, CV, reference ne pune te ngjashme furnizim me uje dhe të listuar në listpagesen e shoqërisë:

- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 12.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit i eshte referuar natyres se sherbimit per projektet pjese e kesaj procedure, te secilat do te jene te licensuar per sherbimet qe priten te realizohen.

- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik

Nevojitet per hartimin e projektit te ujesjellesit sipas zonave te parashikuara dhe depove

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi

Nevojitet per hartimin e projektit te ujesjellesit te objektev dhe shtresave rrugore ku do kalojne linjat.

2.3.6 Operatori ekonomik, duhet të ketë staf ndihmës si më poshtë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, çertifikate, licensë profesionale, CV, reference ne pune te ngjashme furnizim me uje:

- 1 (një) Inxhinier Gjeodet
- 2 (dy) Inxhinier Hidroteknik te Çertifikuar per modelime hidraulike te sistemeve te furnizimit me uje.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 12.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit i eshte referuar detyres se projektimit, natyres se pergjithshme te sherbimeve qe priten te ofrohen. Prezenca e stafit te mesiperem eshte gjykuar e domosdoshme dhe e nevojshme per nje shperndarje dhe efikasitet sa me te madh ne realizimin e sherbimeve konkretisht;

- 1 (një) Inxhinier Gjeodet

Nevojitet per matjet topografike, hartimin e relievit dhe azhornimit te objekteve ekzistuese.

- 2 (dy) Inxhinier Hidroteknik te Çertifikuar per modelime hidraulike te sistemeve te furnizimit me uje.

Nevojitet per llogaritjet hidraulike te rrjeteve me programe kompjuterike me qellim nxjerjen e humbjeve, presioneve dhe prurjes ne rrjet ne nje kohe relativisht te shkurtes.

2.3.7 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 5 (pesë) punonjës për muajin e fundit të deklaruar, të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhen e fundit të deklaruar.
- b) Listepagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per per periudhen e fundit të deklaruar shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetësore.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 12.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojme se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas detyres së projektimit. *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Numri I mesiper perkon me stafin qe pritet te jete i angazhuar ne kete procedure per periudhen e shërbimit.*

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat sipas Standarteve ISO, të vlefshme (ose ekuivalente), si më poshtë:

- Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente: Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë.
- Shoqëria duhet të paraqesë një certifikate ISO 14001-2015 (e vlefshme) për sistem menaxhial të mjedisit.
- Shoqëria duhet të paraqesë një certifikate ISO 45001-2018 të vlefshme për sistem menaxhial të shëndetit dhe sigurisë në punë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e mësipërme në bazë të angazhimit të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik.

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit” Çertifikatat e cilësive janë bazuar në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurimet.

2.3.9 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qera Pajisjet Gjeodezike në gjendje teknike pune si më poshtë:

- 1 (një) Pajisje GPS
 - Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar ku perfsihet periudha e sherbimit (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënësit original ose fotokopje e noterizuar).
- 1(një) Pajisje Dron
 - Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar ku perfsihet periudha e sherbimit (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënësit original ose fotokopje e noterizuar).

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 12.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. GPS perdoret per te vendosur pikat e bazamentit gjeodezik te rretit, ndersa paisja Dron per te kryer rilevimin e zones se projektit ne nje kohe sa me te shkurter.

2.3.10 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qera Automjete për mbulimin e nevojave të transportit për inxhinierët, si më poshtë:

- 2 (dy) Automjete
 - Për automjetin kur eshte në pronësi të paraqitet çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, siguracioni dhe certifikata e kontrollit teknik. Për automjetet me qira krahas dokumentacionit të mësipërm të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirasë ku perfsihet periudha e sherbimit.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 12.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.11 Operatori ekonomik, duhet te paraqesë nje CV te shoqerise dhe stafit te propozuar, ku te perfshihen kontrata te ngjashme, Referenca/Vertetime, Certifikata ISO, Organigrane, Metodologji, Trajnime, Kualifikime, per qellime te vleresimit.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 2/b dhe 5 të nenit të 87, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 45, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, 2. *Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor; në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.*

Kritere të tilla mund të përfshijnë:

organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës;

Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet te plotesoje oferten (Shtojcen 1 dhe 2), duke ju referuar njoftimit të bërë me shkresen Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” i azhornuar. Fondi limit i perlllogaritur i kesaj proçedure eshte vlera minimale sipas nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” i azhornuar.

Argumentimi: Kriteri bazohet ne rekomandimin e Agjensia e Prokurimit Publik me shkrese Nr.5585 Prot. datë 25.07.2017 ”Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne VKM nr.354 date 11.05.2016” dhe shkreses Nr. 13565 Pro.t date 06.11.2017 ”Terheqim Vemendjen”.

Me qellim garantimin e realizimit te sherbimit ne kohe dhe me cilesi eshte gjykuar se respektimi i legjislacionit ne fuqi eshte i domosdoshem.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.